

RAPORT I TRANSPARENCËS

Përgatitur në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 10 091 datë 5.03.2009, i ndryshuar “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar” dhe aktet nënligjore përkatëse

Për vitin financiar që përfundon më **31 Dhjetor 2024**

1. Informacion i përgjithshëm mbi firmën e auditimit

- Emri ligjor i subjektit të auditimit: **ELTON MERSINI**
- Forma juridike e organizimit: **Person fizik**
- Adresa e selisë qendrore: **L: Sul Papri, Rr: Sul Papri, Pall 134, Ap 14**
- Numri i identifikimit fiskal (NIPT): **K33322201U**
- Data e regjistrimit: **15.09.2003**
- Numri i licencës së auditimit: **170**
- Autoriteti lëshues i licencës: **Instituti Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA)**
- Auditues i vetëm i regjistruar: **Elton Mersini, Auditues Ligjor.**

2. Strukturë organizative dhe qeverisje e brendshme

Struktura organizative e firmës është e orientuar drejt thjeshtësisë dhe efikasitetit, duke reflektuar përmasat dhe natyrën e saj si njësi e drejtuar nga një auditues i vetëm.

Audituesi është përgjegjës për:

- Menaxhimin strategjik dhe operativ të firmës;
- Pranimin dhe mbajtjen e klientëve;
- Mbikëqyrjen e cilësisë së angazhimeve;
- Zbatimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të cilësisë;
- Zhvillimin profesional të vazhdueshëm.

3. Sistemi i kontrollit të brendshëm të cilësisë

Firma zoteron dhe zbaton një Manual të Menaxhimi të Cilësisë në përputhje me Standardin Ndërkombëtar për Menaxhimin e Cilësisë 1 (SNMC 1), i cili përfshin:

3.1 Komponentët kryesorë të sistemit:

- Udhëheqja dhe qeverisja
- Përcaktimi i objektivave të cilësisë
- Vlerësimi i rrezikut të cilësisë
- Monitorimi dhe vlerësimi
- Dokumentimi

3.2 Monitorimi dhe rishikimi:

Firma angazhohet në vetëvlerësime vjetore dhe, kur është e nevojshme, në rishikime të jashtme të cilësisë. Kontrolli i fundit i Cilësisë për firmën është kryer në vitin 2014.

4. Politikat për pranimin dhe ruajtjen e klientëve

Procesi për pranimin dhe ruajtjen e klientëve përfshin:

- Vlerësimin e pavarësisë dhe paanshmërisë;
- Vlerësimin e integritetit të menaxhimit të klientit;
- Vlerësimin e përputhshmërisë me kërkesat ligjore;
- Aftësinë për të ofruar një angazhim me cilësi të lartë.

5. Pavarësia dhe pajtueshmëria me kërkesat etike

Audituesi dhe firma janë të përkushtuar ndaj ruajtjes së pavarësisë, objektivitetit, konfidencialitetit dhe kompetencës profesionale në përputhje me:

- Ligjin për Auditimin Ligjor;
- Kodin Etik të IFAC dhe të IEKA;
- Rregulloret e Autoritetit Mbikëqyrës.
- Rregulloret e brendshme të firmës.

6. Trajnimi profesional i vazhdueshëm (TPV)

Audituesi ndjek dhe dokumenton TPV në përputhje me kërkesat e ligjit dhe të autoritetit rregullator. Gjatë vitit 2024, janë përfunduar gjithsej **40** orë trajnime të akredituara që përfshijnë:

- Zbatimin e standardeve SNA dhe SNMC;
- Zhvillimet në legjislacionin kontabël dhe fiskal;
- Etikën profesionale dhe auditimin;
- Teknologjitë e reja dhe auditimin dixhital.

7. Informacion mbi klientët dhe të ardhurat

Lloji i të ardhurave	(000) ALL	Përqindja
Të ardhura nga auditimi ligjor	1,646	72%
Të ardhura nga shërbime të tjera	655	28%
Të ardhura totale	2,301	100%

- Numri i klientëve të audituar: 9
- Numri i NIP-ve të audituara: 3
- Firma nuk ka ofruar shërbime të ndaluara për klientët ekzistues të auditimit.

Lista e njesive me interes publik (NIP) te audituar ne vitin 2024.


Shoqëritë e Audituar (NIP)
Technip Energies Italy S.p.A.-Dega Tirane
Ermir sh.p.k
Adria Entertainment sh.a

8. Angazhimi për transparencë dhe përgjegjësi ligjore

Ky raport përgatitet në përputhje me nenin 45 të Ligjit nr. 10 091 datë 5.03.2009, i ndryshuar "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar.

Audituesi përgjegjës deklaron se:

"Raporti i transparencës është përgatitur në mënyrë të paanshme dhe të saktë, duke pasqyruar realisht strukturën, politikat dhe aktivitetet e firmës së auditimit për periudhën e raportimit."


ELTON MERSINI
Auditues Ligjor
NIPT: K33322201U
Lic.Prof:Nr.170 Dt.21.09.2007
Mobile: 0692056750 Elbasan